

VENDIM
Nr. 202, datë 9.4.2014

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE PËR EKSPORTUESIT PËR QËLLIM
TË RIMBURSIMIT TË TVSH-së**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 4 e 5 të nenit 50 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin si eksportues, për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, të personit të tatueshëm:
 - a) Që eksporton sipas kuptimit të neneve 181 dhe 182 të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;
 - b) Nëse vlera e eksporteve të bëra në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, përbën më shumë se 60% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet;
 - c) Nëse ka tepërsi kreditore, që tejkalon shumën 400 000 (katërqind mijë) lekë.
2. a) Eksportues me risk zero është personi i tatueshëm eksportues, sipas pikës 1, që plotëson kushtet e mëposhtme:
 - i) Vlera e eksporteve të bëra në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, përbën 100% të vlerës së përgjithshme të shitjeve;
 - ii) Ka aktivitet eksportues mbi dy vjet;
 - iii) Paraqet si dokument prove të kryerjes së eksportit, deklaratën doganore të eksportit, lëshuar sipas legjislacionit doganor në Republikën e Shqipërisë;
 - iv) Nuk ka detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- b) Për personat e tatueshëm, të klasifikuar me risk zero, sipas kësaj pike, miratimi i rimbursimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore bëhet pavarësisht nga kontrolli tatimor, i cili mund të kryhet në çdo moment, sipas planifikimit për kontroll. Procedura e rimbursimit kryhet sipas përcaktimeve të bëra në nenin 50 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, dhe të udhëzimit nr. 17, datë 13.5.2008, të ministrit të Financave “Për TVSH-në”, të ndryshuar.
3. Eksportuesi, që nuk plotëson kushtet e pikës 2 të këtij vendimi, rimbursohet për TVSH-në brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, sipas procedurës së përcaktuar në udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008, të ministrit të Financave “Për TVSH-në”, të ndryshuar.
4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama